

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСË СË ВЕРИУТ  
ЈАВНО ПРЕТПРИЈАТИЕ ЗА ДРЖАВНИ ПАТИШТА  
НДËРМАРРЈА ПУБЛИКЕ ПËР РРУГË СХТЕТËРОКЕ  
Бр.-Нр. 01-5353/1  
12-06-2023 20 год.-viti  
СКОПЈЕ - ШКУП

НДËРМАРРЈА ПУБЛИКЕ ПËР РРУГË СХТЕТËРОРЕ

*RAPORTI I PUNËS SË*  
*НДËРМАРРЈЕС ПУБЛИКЕ ТË РРУГËВЕ СХТЕТËРОРЕ*  
*për vitin 2022*

*Shkup, maj 2023*

Në bazë të nenit 11 pika 7 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19, 89/22 dhe 274/22), Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore dorëzon Raport vjetor për punën e saj për vitin paraprak në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PËRMBAJTJA:

I.	HYRJA .....	4
II.	ORGANET E MENAXHIMIT NË NPRRSH .....	6
III.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM I NPRRSH .....	15
IV.	AUDITIMI I BRENDSHËM .....	19
V.	RAPORTIM FINANCIAR.....	20
VI.	IVESTIMET .....	45
VII.	FURNIZIMET PUBLIKE.....	69

## I. HYRJE

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore (në tekstin e mëtutjeshëm: NPRRSH) është themeluar me 03.01.2013 me Vendimin për themelimin nr. 41-10147/1 të datës 28.12.2012 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.1 e datës 02.01 .2013. Ndërmarrja është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë me NVAS 6839673 dhe është trashëgimtare ligjore e Agjencisë për rrugë shtetërore Shkup.

Qëllimi dhe veprimtaria kryesore e NP për Rrugët Shtetërore është planifikimi, ndërtimi, rikonstruimi, rehabilitimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugëve dhe menaxhimi i rrugëve shtetërore. Me këtë, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore mbetet shtytës i infrastrukturës rrugore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kompetencat e NPRRSH-së janë:

1. Menaxhimi i rrugëve shtetërore;
2. Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i rrugëve shtetërore;
3. Marrja e masave për shfrytëzimin racional të mjeteve të dedikuara për rrugët shtetërore;
4. Kryerja e punëve investuese në fushën e rrugëve shtetërore
5. Pagesë të kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike;

6. Huazim te institucionet financiare vendase dhe të huaja;
7. Organizimi i përgatitjes së studimeve dhe projekteve për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe pagesën e taksave rrugore me të drejtë që këta t'ia lë personave fizikë dhe juridikë në përputhje me ligjin;
8. Sigurimi i ndërtimit, rikonstruimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve shtetërore personave juridikë në pajtim me ligjin;
9. Propozimi i vendimit për fillimin e procedurës për dhënien e koncesionit dhe/ose llojeve të tjera të partneritetit publiko-privat;
10. Lëshimin e miratimeve, lejeve dhe mendimeve në pajtim me Ligjin për rrugët publike;
11. Organizimi i aktiviteteve lidhur me numërimin e trafikut, mbrojtjen e rrugëve shtetërore, kadastrën e rrugëve shtetërore dhe formimin e bazave të nevojshme të të dhënave;
12. Aplikimi dhe përdorimi i një sistemi të menaxhimit të mirëmbajtjes së rrugëve (RMS) dhe i një sistemi të menaxhimit të mirëmbajtjes së urëve (BMS);
13. Mbështetje për ndërtimin, rikonstruimin dhe rehabilitimin e rrugëve që nuk janë rrugë shtetërore, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Raporti për punën mbulon funksionimin e përgjithshëm të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2022, funksionimin e organeve drejtuese të NPRRSH-së, funksionimin e auditimit të brendshëm, rezultatet e arritura financiare për vitin 2022, investimet në projektet e infrastrukturës rrugore në vitin 2022 dhe realizimin e programit vjetor për vitin 2022, si dhe të furnizimet publike të realizuara në vitin 2022, në përputhje me kompetencat e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore të përcaktuara në Ligjin për Rrugët Publike dhe Statutin e NP për Rrugë Shtetërore.

Sipas Ligjit për rrugë publike, Programi vjetor për ndërtim, rikonstruim,

rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2022 është miratuar nga Bordi drejtues i NPRRSH-së dhe është marrë pëlqimi nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **I. ORGANET E MENAXHIMIT TË NPRRSH:**

Organet drejtuese të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore janë:

- Bordi drejtues
- Bordi mbikëqyrës për kontroll të punës materiale-financiare,
- Drejtori

### **1. PUNA E BORDIT DREJTUES**

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 21 seanca të Bordit Drejtues.

- Miratimi i Programit vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022
- Miratimi i Programit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022 me NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale
- Miratimi i Planit vjetor për furnizim publik 2022 i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore.
- Miratimi i Vendimit për shpërndarjen e mjeteve për ndërtimin, rikonstruimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve dhe rrugicave komunale për vitin 2022
- Miratimi i Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për llogaritjen e pagave të të punësuarve në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2022

- Miratimi i Vendimit për shumën e maksimumit të arkës për vitin 2022.
- Miratimi i Vendimit ndaj Ankesës të punëtorit Erdin Osmani kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore me gjobë në para
- Miratimi i Vendimit ndaj Ankesës të punëtorit Bojan Ristovski kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore me gjobë në para
- Miratimi i Vendimit ndaj Ankesës të punëtorit Zoran Ristovski kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore me gjobë në para
- Miratimi i Vendimit për Lutje për ndihmë të të punësuarit Elham Jashari
- Raporti për regjistrimin e kryer të mjeteve bazë dhe inventarit të imët në NPRRSH për vitin 2021.
- Miratimi i Vendimit për fshirje – shpenzime të mjeteve bazë për vitin 2021
- Miratimi i Vendimit për fshirje - shpenzime të inventarit të imët për vitin 2021
- Miratimi i Raportit për regjistrimin e mjeteve në para, kërkesave, detyrimeve dhe operacioneve materiale të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore më 31.12.2021.
- Miratimi i Vendimit me kërkesë të Komunës së Bogovinës.
- Miratimi i Vendimit për lidhjen e Kontratës ndërmjet NPRRSH-së dhe Tirena Scavi Italisë për ndërtimin e segmentit Dllabocicë - Çatal, pas prishjes së kontratës për ndërtimin e një rruge të shpejt.
- Miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistemimin e vendeve të punës në NPRRSH dhe miratimi i Vendimit për dhënie e pëlqimit për të njëjtën.
- Miratimi i Rregullores për mënyrën dhe procedurën e vlerësimit dhe procedurën për avancimin e personave tekniko ndihmës në NPRRSH.
- Miratimi i Vendimit me kërkesë të Komunës së Tearcës.
- Miratimi i Vendimit pas Kërkesës për caktimin e përdorimit të përhershëm të

automjeteve të udhëtimit të paraqitur nga NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale.

- Miratimi i Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për llogaritjen e pagave të punëtorëve në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2022.
- Miratimi i Llogarisë Vjetore të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2021.
- Miratimi i Vendimit për përdorimin e fondeve të krijuara nga funksionimi i NPRRSH për vitin 2021.
- Miratimi i Vendimit për fillimin e procedurës për huamarrje me garanci shtetërore për financimin e ndërtimit të autostradës A4, segmenti kalimi kufitar Bllacë Shkup (kryqëzimi Stenkovec) Nënsegmenti i dytë.
- Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorit të NPRRSH-së dhe miratimi i Vendimit për një udhëtim zyrtar jashtë vendit.
- - Ndryshimi dhe plotësimi i Programit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022 me NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale.
- Miratimi i Vendimit për lidhjen e Kontratës ndërmjet NPRRSH dhe GIM SHA Shkup, lidhur me Kontratën për mbikëqyrje për përfundimin e punëve ndërtimore për ndërtimin e autostradës A2, segmenti Kërçovë - Ohër.
- Miratimi i Raportit për punë financiare të Ndërmarrjes në tremujorin e katërtë të vitit 2021
- Miratimi i Raportit për punë financiare të Ndërmarrjes në gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2021
- Miratimi i Vendimit për kërkesën për donacion të masës të drurit të komunës së Pllasnicës.
- Miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagat dhe shtesat e punëtorëve të NPRRSH-së.



- Miratimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimin e filialeve të NPRRSH.
- Miratimi i Vendimit ndaj Ankesës të punëtorit Maja Ackovska kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore me vërejtje me shkrim
- Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorit të NPRRSH-së dhe miratimi i Vendimit për një udhëtim zyrtar jashtë vendit.
- Miratimi i Planit për ndryshimin dhe plotësimin e planit vjetor për furnizime publik për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.
- Miratimi i Raportit të punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e parë të vitit 2022.
- Miratimi i Rregullores për ndryshimin e rregullores për organizimin e brendshëm të NPRRSH-së.
- Miratimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në NPRRSH.
- Miratimi i Vendimit për Kërkesën për pagesën e ndihmës solidare nga i punësuari Ismail Toçi.
- Miratimi i Vendimit pas Kërkesës për ndihmë financiare nga Sindikata për perkujdesje dhe edukim të fëmijëve në Maqedoni.
- Miratimi i Vendimit ndaj Ankesës të punëtorit Sasho Trençevski kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore
- Miratimi i vendimit për kërkesën për donacion për një operacion nga Xhenet Fejzuloska.
- Miratimi i Planit për ndryshimin dhe plotësimin e planit vjetor për furnizime publik për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.
- Miratimi i Rregullores për ndryshimin e rregullave për organizimin e brendshëm të NPRRSH-së.
- Miratimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në NPRRSH.
- Miratimi i Raportit për punën e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2021.

- Miratimi i Vendimit për pagesën e regresit së pushimeve për vitin 2022.
- Miratimi i Vendimit për pranimin e Çmimeve për pagesën e shërbimeve të NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale.
- Miratimi i Vendimit pas Kundërshtimit kundër Vendimit për caktim të vendit të punës dhe përcaktimin e pages nga i punësuari Sasho Trençevski.
- Miratimi i vendimit për kërkesën për ndihmë financiare të njëhershme për të punësuarën Vildane Ahmeti
- Miratimi i Planit për ndryshimin dhe plotësimin e planit vjetor për furnizime publik për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.
- Miratimi i Vendimit për Kërkesë për ndihmë financiare nga KSH Stevo Patako - Manastir.
- Miratimi i Planit për ndryshimin dhe plotësimin e planit vjetor për furnizime publik për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.
- Miratimi i Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore
- Miratimi i Raportit për punë financiare të Ndërmarrjes në tremujorin e dytë të vitit 2022
- Miratimi i Raportit për punë financiare të Ndërmarrjes në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2022
- Miratimi i Vendimit pas kërkesës për donacion nga NP për menaxhimin e rrugëve shtetërore, Pyjet nacionale - Shkup.
- Miratimi i Tekstit të spastruar të Statutit të NPRRSH.
- Miratimi i Programit për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022.
- Miratimi i planit për plotësimin e Planit Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore.
- Lidhja e Kontratës kolektive për ndryshimin e Kontratës kolektive të NPRRSH me Sindikatën e NPRRSH.
- Miratimi i Rregullores për ndryshimin e rregullores për pagën dhe shpërblimin e të punësuarve në NPRRSH.

- Miratimi i vendimit për kërkesën për ndihmë financiare për të punësuarën Dragica Gasparova
- Miratimi i Planit për ndryshim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore
- Miratimi i Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të NPRRSH.
- Miratimi i Vendimit për miratimin e Planit Financiar të NPRRSH për vitin 2023.
- Miratimi i Raportit të punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e tretë 2022.
- Miratimi i Vendimit pas njoftimit të Bordit Drejtues nga Drejtori i NPRRSH, lidhur me situatën me paraqitjen e monedhave të falsifikuara në pikat pagesore në RMV.
- Miratimi i Vendimit për donacion NP për menaxhim me pyjet shtetërore, Pyjet nacionale - Shkup, sipas konkluzionit të Qeverisë së RMV me datë 25.8.2022 (për projektin e ndërtimit të autostradës Kërçovë - Ohër).
- Miratimi i Vendimit për donacion NP për menaxhim me pyjet shtetërore, Pyjet nacionale - Shkup, sipas konkluzionit të Qeverisë së RMV me datë 25.8.2022 (për projektin e ndërtimit të rrugës shtetërore segmenti Ura e Garskit).
- Miratimi i Vendimit me kërkesë të Komunës së Likovës.
- Miratimi i Vendimit për shkarkimin dhe emërimin e ndihmës procesverbalistit të Bordit Drejtues.
- Miratimi i Vendimit për Kërkesën për Ndhmë Financiare për të punësuarën Susana Atanasova.
- Miratimi i aktvendimit pas kundërshtimit të Igor Boroviqit kundër vendimit për gjobën e shqiptuar.
- Miratimi i Programit për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022.
- Miratimi i Vendimit për fillimin e procedurës së huamarrjes me qëllim të dhënies së garancionit bankar për nevojat e procedurës së shpronësimit për ndërtimin e autostradës A2, segmenti Kërçovë - Ohër.

- Miratimi i Vendimit për donacion NP për menaxhim me pyjet shtetërore, Pyjet nacionale - Shkup, sipas konkluzionit të Qeverisë së RMV me datë 25.8.2022 (për projektin e ndërtimit të autostradës Kërçovë - Ohër).
- Miratimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës në departamentin për pagesën të taksës rrugore dhe kontroll.
- Miratimi i Vendimit për pagesën e bonusit në vitin 2022.
- Shqyrtimi i Kërkesës së Drejtorit të NPRRSH-së dhe miratimi i Vendimit për një udhëtim zyrtar jashtë vendit.
- Miratimi i Programit vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2023.

## **2. PUNA E BORDIT MBIKËQYRËS PËR KONTROLL TË PUNËS MATERIALE - FINANCIARE TË NDËRMARRJES PUBLIKE**

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 19 seanca të Bordit Mbikëqyrës për kontrollin e punës materiale-financiare të NPRRSH-së.

Në seancat e mbajtura, Bordi Mbikëqyrës ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendim lidhur me aktet dhe vendimet e mëposhtme të rëndësishme në lidhje me punën e NPRRSH-së

- Dhënia e mendimit për Programin vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022
- Dhënia e miratimit të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore
- Dhënia e miratimit të Programit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022 me NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale
- Dhënia e miratimit të Vendimit për shpërndarjen e mjeteve për ndërtimin, rikonstruimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve dhe rrugicave komunale për vitin 2022

- Dhënia e miratimit të Vendimit për lartësinë e maksimumit të arkës për vitin 2022
- Miratimi i Vendimit për shlyerje – detyrim për vitin 2021
- Dhënia e miratimit për lidhjen e Kontratës ndërmjet NPRRSH dhe Tirena Skavi S.p.A. Italia për ndërtimin e segmentit Dllabocicë – Çatal, pas prishjes së Kontratës për ndërtim të rrugës së shpejtë, të miratuar nga Bordi Drejtues.
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e katërtë të vitit 2021.
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në gjysmën e dytë të vitit 2021.
- Dhënia e mendimit për Llogarinë Vjetore të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për vitin 2021.
- Dhënia e miratimit të Vendimit për fillimin e procedurës për huamarrje me garanci shtetërore për financimin e ndërtimit të autostradës A4, segmenti vendkalimi kufitar Bllacë - Shkup (kryqëzimi Stenkovec) nënsegmenti i dytë.
- Dhënia e miratimit të Vendimit për lidhjen e Kontratës ndërmjet NPRRSH dhe GIM SHA Shkup, lidhur me Kontratën për mbikëqyrje për përfundimin e punëve ndërtimore për ndërtimin e autostradës A2, segmenti Kërçovë - Ohër.
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e parë të vitit 2022.
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës së NPRRSH për vitin 2021
- Dhënia e miratimit për Vendimin për pagesën e regresit për pushimin vjetor për vitin 2022, miratuar nga Bordi Drejtues
- Dhënia e miratimit të Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e dytë të vitit 2022.
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në gjysmën e

parë të vitit 2022.

- Dhënia e miratimit të Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues
- Dhënia e miratimit të Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues
- Dhënia e miratimit të Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues
- Shqyrtimi dhe dhënia e mendimit të Planit financiar për vitin 2023
- Dhënia e mendimit për Raportin e punës financiare të ndërmarrjes në tremujorin e tretë të vitit 2022.
- Dhënia e miratimit të Planit për ndryshim dhe plotësim të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues
- Dhënia e miratimit të Vendim për fillimin e procedurës së huamarrjes me qëllim të dhënies së garancisë bankare për nevojën e procedurës së shpronësimit për ndërtimin e autostradës A2, segmenti Kërçovë-Ohër.
- Shqyrtimi dhe dhënia e miratimit të Vendimit për pagesë të bonusit në vitin 2022 të miratuar nga Bordi Drejtues më datë 23.12.2021
- Miratimi i Vendimit për përzgjedhje të kryetarit të Bordit mbikëqyrës në NP për Rrugë Shtetërore
- Dhënia e mendimit për Programin vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2023

## 1. DREJTORI I NPRRSH

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore udhëhiqet nga një drejtor, i cili ka një zëvendës që e zëvendëson dhe menaxhon punën aktuale të ndërmarrjes publike në mungesë të tij.

Puna e Drejtorit të NPRRSH-së gjatë vitit 2022 kishte për qëllim realizimin e Programit vjetor për ndërtimin, rikonstruim, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen

e rrugëve shtetërore dhe kujdesin për ligjshmërinë në funksionimin dhe zbatimin e rregulloreve, statutit dhe akteve të tjera të ndërmarrjes. Drejtori ka punuar duke zbatuar vendimet dhe konkluzionet e Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike, ka organizuar dhe menaxhuar procesin e punës së NPRRSH-së, ka realizuar Programin vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2022. Gjithashtu ka lidhur kontrata për realizimin e programeve dhe kontrata të tjera për nevojat e funksionimit aktual të Ndërmarrjes Publike. Ka kryer rregullisht të gjitha përgjegjësitë e tjera të përcaktuara me Statutin e Ndërmarrjes Publike, në drejtim të sigurimit të ligjshmërisë në funksionimin dhe realizimin e qëllimeve dhe detyrave kryesore të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.

## II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I NPRRSH

Në kuadër të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore janë përcaktuar:

- 8 vende pune të veçanta edhe atë: 5 ndihmës drejtorë dhe 3 këshilltarë të pavarur të drejtorit
- 3 departamente të pavarura, si njësi organizative që nuk janë pjesë e Sektorit, por janë nën kompetencë të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Ndërmarrjes Publike, edhe atë: Departamenti për auditim të brendshëm, Departamenti për teknologji të informacionit dhe komunikimit dhe Departamenti për organizimin dhe mbështetjen e punës së drejtorit
- 7 Sektorë, si njësi organizative nën kompetencë të drejtpërdrejtë të Ndhmës Drejtorit dhe 18 Departamente brenda sektorëve, edhe atë

1. SEKTORI I FINANCAVE
  - 1.1 Departamenti për planifikim financiar, marketing dhe shitje
  - 1.2 Departamenti për pagesat ndërkombëtare dhe monitorimin e kontratave me institucionet financiare ndërkombëtare
  - 1.3 Departamenti për kontabilitet dhe pagesave
  
2. SEKTORI PËR ÇËSHTJET JURIDIKE, RESURSE NJERËZORE DHE ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME
  - 2.1 Departamenti për çështje juridike, përfaqësim, përgatitje dhe monitorim të shpronësimeve
  - 2.2 Departamenti për resurse njerëzore dhe çështjeve të përgjithshme
  
3. SEKTORI PËR FURNIZIME PUBLIKE
  - 3.1 Departamenti për mbështetje administrative dhe teknike për furnizime publike
  - 3.2 Departamenti për zbatimin e procedurave për furnizim publik
  
4. SEKTORI PËR INVESTIME ME MJETET TË RMV-së
  - 4.1 Departamenti për investime dhe ndërtim të rrugëve me mjete nga RMV-së
  - 4.2 Departamenti për përgatitje teknike dhe planifikim me mjete nga RMV-së
  
5. SEKTORI INVESTIMEVE ME MJETE TË IFN
  - 5.1 Departamenti për Investime dhe ndërtimit të rrugëve me mjete nga IFN
  - 5.2 Departamenti për përgatitjen e tenderëve për projektet e financuara me mjete nga IFN
  - 5.3 Departamenti për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale



6. SEKTORI PËR MIRËMBAJTJE, MBROJTJE TË RRUGËVE DHE PAGESË TË TAKSËS RRUGORE

6.1 Departamenti për mirëmbajtjen e rrugëve dhe objekteve elektroenergjetike

6.2 Departamenti për mbrojtje të rrugëve


6.3 Departamenti i pagesë të taksës rrugore dhe kontroll

6.4 Departamenti për kontroll të trafikut

7. SEKTORI PËR SIGURIM TË RRUGËVE DHE MENAXHIM ME RRUGËT

7.1 Departamenti i RAMS - Sistemi për menaxhim të rrugëve

7.2 Departamenti për siguri në rrugë



Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Ndërmarrje më 31 dhjetor 2022 është 496, nga të cilët 355 janë të punësuar janë me kohë të pacaktuar dhe 141 përmes agjencisë së punësimit të përkohshëm deri më 31.12.2022. Gjatë vitit 2022 në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore kanë themeluar marrëdhënie pune gjithsej 12 persona në periudhë të caktuar, edhe atë 5 persona përmes transferimit nga institucionet e tjera dhe 7 persona përmes shpalljes publike.

Paga mesatare bruto e paguar në vitin 2022 është 52.691 denarë, ndërsa paga mesatare neto është 35.048 denarë. Të ardhurat mujore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe Mbikëqyrës të NPRRSH-së janë: Kryetari 12.000 denarë, nënkryetari 11.000 denarë, anëtarët 10.000 denarë. Si kompensim për shpenzimet materiale, përkatësisht shpenzimet për përdorimin e celularit dhe shpenzimet e udhëtimit, kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të BD dhe BM ju paguhet pagesë mujore prej 2.000 denarë

Në Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore në vitin 2022, numri i përgjithshëm i dokumenteve hyrëse/të brendshme/dalëse është 39.551 nga të cilat: 18.220 janë dokumente hyrëse, 7.604 dokumente të brendshme dhe 13.727 dokumente dalëse.

Pasqyrë të numrit të dokumenteve hyrëse/ të brendshme /dalëse në NPRRSH për vitin 2022 sipas sektorëve:

Sektori		Dokumentet hyrëse	Dokumentet e brendshme	Dokumentet dalëse	Gjithsej
1	Organizim dhe zhvillim	2	0	3	5
2	Menaxhim dhe udhëheqje	300	1030	278	1608

3	Punë zyre- arkivave të përgjithshme dhe çështjeve juridike	4191	712	1185	6088
4	Resurset njerëzore	142	3882	147	4171
5	Financiare dhe materiale	4068	70	315	4453
6	Mbrojtja dhe siguria	0	1	0	1
7	PAL	0	1	0	1
8	Furnizimet publike	330	1398	1065	2793
9	Investimet	4727	196	953	5876
10	Mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugëve, pagëes të taksës rrugore dhe kontroll, siguria dhe menaxhimi i rrugëve	4236	294	9670	14200
11	Auditim i brendshëm	1	12	0	13
12	IPA	215	3	107	325
13	TIK	8	5	4	17
<b>Gjithsej</b>		<b>18220</b>	<b>7604</b>	<b>13727</b>	<b>39551</b>

### III. AUDITIMI I BRENDSHËM

Në Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2022 janë planifikuar 3

auditime dhe konkretisht:

- Auditimi i sistemit të IPA II – Auditim i operacioneve në kuadër të IPA 2 .
- Auditim të Sistemit të pagesës së taksës rrugore dhe procesit të faturimit të jopaguesve (persona që nuk paguajnë taksë rrugore) Follow up auditim-Implementimi i rekomandimeve.
- Auditimi me kërkesë të Drejtorit

Auditimet e planifikuara sipas Planit Vjetor për vitin 2022, për kryerjen e një auditimi të brendshëm.

#### **IV. RAPORTIM FINANCIAR**

Raportet financiare e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore janë përpiluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara në Rregulloren e Kontabilitetit Gazeta Zyrtare e RM nr. 159/2009 (të zbatueshme nga 1 janari 2010), Gazeta zyrtare e RM nr. 164/2010 të datës 20.12.2010 dhe Gazeta zyrtare e RM nr. 107/2011 të datës 10.08.2011.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2022 dhe 2021. Aty ku është e nevojshme, të dhënat krahasuese janë rregulluar dhe harmonizuar në përputhje me prezantimin e bërë në vitin aktual.

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Rregullores së Kontabilitetit, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore është e obliguar të mbajë evidencë kontabiliste të kapitalit, mjeteve, kërkesave, detyrimeve, të ardhurave, shpenzimeve dhe të përcaktojë rezultatin financiar të punës sipas Llogarisë Vjetore.

Mjetet financiare të cilat NPRRSH i përdor për ndërtim, rikonstruim,, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore, në pajtim me Ligjin për rrugë publike sigurohen nga:

- 1) pjesë të akcizës nga derivatet e naftës;;
- 2) kompensim për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe automjetet me rrimorkio (taksë rrugore)
- 3) kompensim për shfrytëzimin e rrugës publike, pjesë të saj ose e objektit ne rruge (taksa rrugore);
- 4) kompensim për:
  - a) vendosjen e mbishkrimeve dhe të tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
  - b) lidhja e rrugës hyrëse me rruge shtetërore,
  - c) vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtëse te rrugës shtetërore,
  - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve komerciale në të cilat lejohet gasja në rruge shtetërore jashtë vendbanimit;
  - d) shfrytëzimi i tepruar i rrugës,
  - dh) transport i jashtëzakonshëm dhe
  - e) dëmi i shkaktuar në rrugë dhe objektet rrugore;
- 5) mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) hua dhe kredite
- 7) të hyra të tjera

Raportet financiare përgatiten duke u bazuar në supozimin e vazhdimësisë së punës, përkatësisht se Ndërmarrja do të vazhdojë të punojë në të ardhmen e parashikueshme. Ndërmarrja nuk ka asnjë qëllim ose nevojë për të likuiduar ose kufizuar materialisht fushën e punës së saj.

## 1. BILANCI I GJENDJES

Bilanci i gjendjes tregon gjendjen e mjeteve dhe burimeve të ndërmarrjes më datë 31.12.2022. Bilanci i gjendjes është një pasqyrë statike dhe kumulative, e cila

vëzhgon ndërmarrjen në një moment të caktuar dhe tregon gjendjen e mjeteve, burimeve dhe kapitalit që rrjedhin nga të gjitha aktivitetet në ndërmarrje që nga themelimi i saj deri në ditën e hartimit të bilancit. Vlerat e zërave në bilanc shprehen sipas shumës së tyre gjatë furnizimit të aktivitetit, të korrigjuara për ndryshimet e ndodhura.

Mjetet në para mbahen në bilancin e gjendjes sipas vlerës nominale. Mjetet në para përbëhet nga një llogari xhiro në denarë dhe në valutë të huaj dhe para në arkë.

Kërkesat për paradhëniet njihen me vlerën e tyre nominale dhe përbëhen nga paradhëniet e dhëna për realizuesit.

Paradhëniet për mjetet fikse përfaqësojnë mjetet e dhëna furnitorëve për blerjen e mjeteve fikse dhe shprehen në shumën e vlerës nominale të tyre.

Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet regjistrohen me vlerën e tyre të blerjes.

Amortizimi i mjeteve fikse llogaritet në bazë të metodës lineare gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të përdorimit të mjeteve bazë. Amortizimi i investimeve në vazhdim nuk llogaritet derisa të aktivizohen aktivitetet në ndërtim.

Detyrimet ndaj furnitorëve shprehen në shumën e shumave nominale që rezultojnë nga transaksionet afariste.

Detyrimet e kredisë përbëhen nga detyrime kreditore afatgjata të marra nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (Banka Botërore, BERZH dhe Eksim Banka) dhe deklarohen sipas vlerës së tyre nominale. Shumat e interesit të rënë dakord deklarohen në favor të detyrimeve të tjera dhe në kurriz të shpenzimeve të financimit. Detyrimet kreditore shprehen sipas kursit të denarit në ditën e bilancit, ndërsa diferencat e kursit regjistrohen në kuadër të të hyrave, përkatësisht shpenzimeve nga financimi.

Provizionet (rezervat për detyrimet) njihen kur Ndërmarrja ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, kur është e mundur që daljet e ardhshme të mjeteve do të ndodhin mbi këtë bazë dhe kur është e mundur të vlerësohet

shuma e detyrimit. Kur pritet kompensim i një pjese të një detyrimi të tillë në të ardhmen, kompensimi njihet si një aktiv i veçantë, por vetëm kur është e sigurt se i njëjti do të merret. Shpenzimet për çdo rezervim njihen në pasqyrën e të ardhurave minus shumën e kompensimit

në mijëra denarë

Analiza  
krahasimor

e

realizimit  
në vitin  
aktual. /  
realizimi  
vitin  
praprak.  
(%)

Analiza  
strukturo  
re Viti  
aktual (%)

1. BILANCI I GJENDJES

E  
REALIZUAR  
në vitin e  
kaluar

E  
REALIZUAR  
në vitit  
aktual

AKTIVA

Mjete në para	2,193,563	2,038,790	0.93	1.68
Kërkesat	217,896	54,403	0.25	0.04
Tepricat	1,670	2,083	1.25	0.00
Mjetet financiare afatshkurtra	0	0	-	0.00
Mjetet të tjera rrjedhëse (AVR)	55,122	81,864	1.49	0.07
<b>Aktiva rrjedhëse</b>	<b>2,468,251</b>	<b>2,177,140</b>	<b>0.88</b>	<b>1.79</b>
Mjetet materiale dhe investime në patundshmëritë	112,504,058	119,337,991	1.06	98.20
Investimet financiare afatgjata	0	0	-	0.00
Mjetet jo-materiale	1,159	7,376	6.37	0.01
Mjetet financiare afatgjata	21,010	6,988	0.33	0.01
<b>Aktiva jorrrjedhëse</b>	<b>112,526,227</b>	<b>119,352,355</b>	<b>1.06</b>	<b>98.21</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>114,994,478</b>	<b>121,529,495</b>	<b>1.06</b>	<b>100.00</b>
Aktiva jashtë bilancit	0	0	-	0.00
Detyrimet afatshkurtra	7,232,060	7,731,447	1.07	6.36

Pagesa e prlonguar e shpenzimeve dhe të ardhurave (PVR)	2,196,970	2,193,456	1.00	1.80
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>	<b>9,429,030</b>	<b>9,924,903</b>	<b>1.05</b>	<b>8.17</b>
Detyrimet afatgjata	43,973,023	46,615,742	1.06	38.36
Detyrime të tjera afatgjata dhe provizione për rreziqet dhe shpenzimet	209,063	157,441	0.75	0.13
<b>Detyrimet jorrjedhëse</b>	<b>44,182,086</b>	<b>46,773,183</b>	<b>1.06</b>	<b>38.49</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>53,611,116</b>	<b>56,698,086</b>	<b>1.06</b>	<b>46.65</b>
Kapitali	5,000	5,000	1.00	0.00
Fitimi i akumuluar	45,512,573	50,108,233	1.10	41.23
Rezervat	4,595,660	1,473,676	0.32	1.21
Rezervat e rivlerësimit	9,796,453	9,796,453	1.00	8.06
Kapitali	1,473,676	3,448,047	2.34	2.84
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>61,383,362</b>	<b>64,831,409</b>	<b>1.06</b>	<b>53.35</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>	<b>114,994,478</b>	<b>121,529,495</b>	<b>1.06</b>	<b>100.00</b>
Pasiva jashtë bilancit	0	0	-	0.00

Totali i aktiveve/pasivave në bilancin e gjendjes në vitin 2022 është 121.529.495.188 denarë. Krahasuar me vitin paraprak 2021, kur ishte 114.994.477.929 denarë, shënoi rritje prej 6%. Në aktivat, rritja më e madhe, sipas analizës strukturore dhe krahasuese, është në aktivet materiale dhe investimet në patundshmëri, pra investimet e vazhdueshme. Ndërsa te pasiva, rritja është më e madhe detyrimet afatgjata a.q. detyrimet për huatë dhe kredi, ndërsa gjithashtu rritje të dukshme ka edhe te detyrimet afatshkurte, në pajtim me analizën strukturore në krahasim me vitin paraprak



## 2. BILANCI I SUKSESIT

Bilanci i suksesit tregon totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga puna e NPRRSH për vitin 2022 dhe rezultatin financiar për të njëjtin vit.

2. BILANCI I SUKSESIT	REALIZI	PLANIFIK	REALIZI	Analia	Analia	Analiza
	MI VITIN	IMI VITIN	MIN	krahasi	imore	
	E	AKTUAL	VITIN	more	realizimi	strukturore
	KALUAR		AKTUAL	realizimi	në vitin	Viti
				në vitin	aktual.	aktual
				aktual. /	/planif	
				realizimi	ikimi	
				vitin	vitin	
				praprak.	aktual.	
				(%)	(%)	(%)

Të hyrat nga shitja	4,630,296	5,673,000	5,117,468	1.11	0.90	50.85
Të hyrat të tjera operative	3,696,521	4,670,000	4,946,980	1.34	1.06	49.15
<b>Të hyrat totale operative</b>	<b>8,326,816</b>	<b>10,343,000</b>	<b>10,064,448</b>	<b>1.21</b>	<b>0.97</b>	<b>100.00</b>
Të hyrat nga shitja	104,390	130,150	212,646	2.04	1.63	4.65
Të hyrat të tjera operative	273,890	385,000	390,736	1.43	1.01	8.55
<b>Të hyrat totale operative</b>	<b>1,957,223</b>	<b>2,600,000</b>	<b>1,987,876</b>	<b>1.02</b>	<b>0.76</b>	<b>43.50</b>

Të hyrat nga shitja	66,532	0	0	0.00	/	0.00
Të hyrat të tjera operative	2,036,865	2,074,000	1,979,058	0.97	0.95	43.30
<b>Të hyrat totale operative</b>	<b>4,438,899</b>	<b>5,189,150</b>	<b>4,570,316</b>	<b>1.03</b>	<b>0.88</b>	<b>100.00</b>
Fitimi nga puna operative	3,887,917	5,153,850	5,494,132	1.41	1.07	0.00
Të hyrat nga financimi	699,350	935,000	3,000,563	4.29	3.21	0.00
Shpenzime nga financimi	3,106,232	1,920,000	4,821,224	1.55	2.51	0.00
Fitimi para tatimit	1,481,035	4,168,850	3,673,471	2.48	0.88	0.00
Tatimi mbi fitimin	7,358	416,885	225,424	30.63	0.00	0.00
<b>Humbja/Fitimi neto</b>	<b>1,473,676</b>	<b>3,751,965</b>	<b>3,448,047</b>	<b>2.34</b>	<b>0.92</b>	<b>0.00</b>

Pjesa e parë e bilancit të suksesit përmban të hyra operative, të cilat arrijnë në 10.064.447.524 denarë, dhe shpenzime operative ose të përgjithshme, të cilat arrijnë në 4.570.315.841 denarë. Diferenca e tyre jep fitimin operativ ose fitimin nga puna, i cili për vitin aktual është 5.494.131.683 denarë. Fitimi operativ në vitin 202 është më i lartë se viti paraparak 2021 për 41%, ndërsa 7% më e lartë se fitimi operativ i planifikuar për vitin 2022. Fitimi i rritur është si rezultat të rritjes së të hyrave nga puna (akcizat, taksa rrugore dhe regjistrimet).

Në pjesën e dytë zërat janë kryesisht të natyrës së jashtme dhe ndërmarrja pothuajse vështirë se mund të ndikojë në to. Ato zëra janë diferencat e kursit pozitiv ose negativ, të cilat varen nga lëvizja e kursit të USD, valuta në të cilën NP për Rrugë

Shtetërore ka lidhur marrëveshjen me Eksim Bankën për financimin e rrugëve Milladinovci - Shtip dhe Kërçovë - Ohër. Si tregues i suksesit të operacionit në analiza, përfaqësohet fitimi operativ, në ndryshim nga fitimi neto, në të cilin diferencat e kursit të këmbimit kanë ndikimin më të madh. Fitimi para tatimit për vitin 2022 është 3.673.470.940 denarë dhe është 248% më i lartë se viti i kaluar raportues. Fitimi neto në vitin 2022 është 3,448,047,142 denarë. Tatimi në fitim për vitin raportues është 225.424.798 denarë..

### 3. TË HYRAT E SPECIFIKUARA

Të hyrat njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të rrjedhin në ndërmarrje dhe nëse këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të hyrat e ndërmarrjes janë përfitime ekonomike që lindin gjatë periudhës së konsideruar, si rezultat i aktiviteteve të rregullta të saj. Të hyrat e ndërmarrjes rrjedhin nga kompensimet e përcaktuara me Ligjin për rrugët publike. Të hyrat nga interesi njihen për periudhën kohore për të cilën janë përcaktuar.


*në mijëra denarë*

3. TË HYRAT E SPECIFIKUA RA	REALIZI		REALIZI MIN VITIN AKTUAL	Analia krahasim ore realizimi në vitin aktual. / realizimi vitin praparak. (%)	Analia krahasim ore realizimi në vitin aktual. /planifiki mi vitin aktual. (%)	Analiza struktur ore Viti aktual (%)
	VITIN E KALUA R	PLANIFIK IMI VITIN AKTUAL				
<b>Të hyrat nga veprimtaria</b>						
Të hyrat nga regjistrimi	1,759,819	2,100,000	1,818,312	1.03	0.87	13.92


Të hyrat nga taksa	2,844,804	3,550,000	3,254,964	1.14	0.92	24.91
Të hyrat nga transporti i jashtëzakonshëm	21,179	20,000	39,655	1.87	1.98	0.30
Të hyrat nga tabelat reklamuese, instalimet, rruga hyrëse, llogore dhe tjera	4,493	3,000	4,536	1.01	1.51	0.03
Të hyrat nga akciza	3,564,333	4,650,000	4,679,921	1.31	1.01	35.82
Të hyrat të tjera nga puna	132,188	20,000	267,059	2.02	13.35	2.04
<b>Të hyrat totale operative</b>	<b>8,326,816</b>	<b>10,343,000</b>	<b>10,064,448</b>	<b>1.21</b>	<b>0.97</b>	<b>77.03</b>
<b>Të hyra të tjera</b>						
Diferencat pozitive të kursit	694,840	930,000	2,975,538	4.28	3.20	22.77
Të hyrat nga interesi	4,511	5,000	25,026	5.55	5.01	0.19
<b>Totali i të hyrave të tjera</b>	<b>699,350</b>	<b>935,000</b>	<b>3,000,563</b>	<b>4.29</b>	<b>3.21</b>	<b>22.97</b>
<b>Të hyrat totale</b>	<b>9,026,166</b>	<b>11,278,000</b>	<b>13,065,011</b>	<b>1.45</b>	<b>1.16</b>	<b>100.00</b>

Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore në vitin 2022 ka realizuar të hyra në vlerë të përgjithshme prej 13.065.010.660 denarë. Të hyrat totale të ndërmarrjes janë rritur për 45% në krahasim me vitin paraprak.

Ilustrim grafik nr. 1: Të hyrat e realizuar në raport me të hyrat e planifikuar të vitit 2022



Ilustrim grafik nr. 2: Të hyrat e realizuar në vitin 2022 krahasur me vitin 2021



Të hyrat operative për vitin 2022 janë 10.064.447.524 denarë dhe janë në kornizë të planifikimit. Të hyrat operative në vitin paraprak 2021 arritën në 8.326.816.042 denarë dhe të njëjtat në vitin 2022 shënuan rritje prej 21%. Sipas analizës strukturore dhe analizës krahasuese të dhënë në tabelën nr. 3, ndërmarrja ka shënuar rënien më të madhe të të hyrave nga taksat

Sipas Ligjit për rrugët publike, të hyrat operative përfshijnë: kompensim për shfrytëzimin e rrugës publike, pjesës apo objektit në rrugë (taksë rrugore), kompensim për shfrytëzimin e rrugëve publike për mjete motorike dhe rimorkio (taksa rrugore) e cila paguhet me regjistrimin e automjeteve dhe të hyrat të tjera që rrjedhin nga veprimtaria.

Masa e kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike për mjete motorike dhe rimorkio (taksa rrugore) që paguhet gjatë **regjistrimit të automjetit**, një herë në vit, përcaktohet në varësi të ndikimit të mjetit në dëmtimin e rrugës. Në vitin 2022 nga ky kompensim janë realizuar të hyra në vlerë prej 1.818.311.945 denarë. Shuma e realizuar është brenda planit dhe është 3% më e lartë krahasuar me vitin paraprak ose rreth 5.5 milionë denarë (0.9 milionë denarë). Të hyrat nga kompensimi për shfrytëzimin e rrugëve publike për mjete motorike dhe rimorkio – taksa rrugore, u zvogëlohen për pagesat pronarëve të mjeteve motorike dhe rimorkio me të cilat kryhet komunikacion ndërkombëtar. Sipas Vendimit për masën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike për mjete motorike dhe rimorkio (taksa rrugore), përcaktohet e drejta e kthimit të një pjese të shumës së paguar në përpjesëtim me kohën që mjete motorik dhe rimorkio kanë kaluar jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Masa e kompensimit për përdorimin e rrugës publike, pjesës së saj ose objektit në rrugë (**taksë rrugore**) përcaktohet në varësi të gjatësisë së segmentit në të cilin paguhet

kompensimi dhe kategorisë së automjetit. Në vitin 2022, këto të hyra arrijnë vlerë prej 3.254.964.390 denarë, që janë 14% më të larta se një vit më parë ose për rreth 410.2 milionë denarë (6.7 milionë euro).


Të hyrat të tjera nga puna përfshijnë kompensime të ndryshme që paguhen në rrugët magjistrale dhe rajonale, siç janë kompensimet për vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave reklamuese në shiritin mbrojtës të një rruge shtetërore, lidhjen e një rruge hyrëse me një rrugë shtetërore, vendosja e instalimeve në bagazhin e rrugës dhe shiritin rrugor i një rruge shtetërore, ndërtimi dhe përdorimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në një rrugë publike jashtë vendbanimit, për përdorim të tepruar të rrugës shtetërore, për transport të jashtëzakonshëm dhe për dëmtim të rrugës shtetërore dhe objekteve në rrugë.

Pjesa e akcizës nga derivatet e naftës është 4.679.921.029 denarë. Sipas Ligjit për rrugë publike, këto mjete transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në llogarinë e Ndërmarrjes Publike së paku katër herë në vit, në intervale prej së paku tre muajsh kalendarikë. Krahasur me vitin 2021 të hyrat janë më të larta për 31% ose për rreth 1.15 miliardë denarë (18.7 milionë euro).

Në total, në krahasim me vitin 2022 me vitin 2021, në bazë të taksave rrugore, regjistrimit dhe akcizës janë realizuar më shumë të hyra në vlerë prej 1,5 miliardë denarë (25 milionë euro).

Të hyrat tjera për vitin 2022 janë 3.000.563.142 denarë. Të hyrat e tjera përfshijnë diferencat pozitive të kursit të këmbimit dhe të hyrat nga interesi. Të hyrat nga interesi njihen për periudhën kohore me të cilën të njëjtat kanë të bëjnë. Këto të hyra janë më të mëdha se vitin paraprak dhe kryesisht janë të natyrës së jashtme dhe për këtë ndërmarrja vështirë se mund t'i planifikojë dhe të ndikojë në realizimin e tyre.

Ilustrim grafik nr.3: Pjesëmarrja e të hyrave individuale në totalin e të ardhurave të realizuara për vitin 2022.



#### 4. SHPENZIMET E SPECIFIKUARA

Shpenzimet njihen në bilancin e suksesit kur ka një rënie në përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me një ulje të një aktivi të caktuar ose një rritje në një detyrim të caktuar që mund të matet me besueshmëri. Shpenzimet njihen bazuar në lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë ndërmjet shpenzimeve të kryera dhe fitimit të të ardhurave specifike.



4.  
SHPENZIME  
T E  
SPECIFIKU  
ARA

REALIZI  
MI  
VITIN E  
KALUA  
R

PLANIFIK  
IMI VITIN  
AKTUAL

REALIZI  
MIN  
VITIN  
AKTUAL

Analia  
krahasim  
ore  
realizimi  
në vitin  
aktual. /  
realizimi  
vitin  
praprak.  
(%)

Analia  
krahasim  
ore  
realizimi  
në vitin  
aktual.  
/planifiki  
mi vitin  
aktual.  
(%)

Analiza  
struktur  
ore Viti  
aktual  
(%)


Shpenzimet nga veprimtaria

Shpenzime për materialet harxhuese, inventar të imët dhe karburant	9,623	10,150	29,510	3.07	2.91	0.31
Shpenzimet për energji	94,767	120,000	183,136	1.93	1.53	1.95
Paga, kompensimet e pagave dhe shpenzime të tjera për të punësuarit	273,890	385,000	390,736	1.43	1.01	4.16
Amortizimi	1,957,223	2,600,000	1,987,876	1.02	0.76	21.17
Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve dhe rrugëve	1,214,504	1,270,000	1,303,775	1.07	1.03	13.88
Shërbime komunale dhe shërbime të	282,599	244,000	166,493	0.59	0.68	1.77


tjera						
Provizion për Shoqëritë e kontrollit teknik	77,826	70,000	79,979	1.03	1.14	0.85
Transfertat në NJVQ	298,208	300,000	300,000	1.01	1.00	3.19
Shpenzimet bankare	29,088	30,000	35,051	1.20	1.17	0.37
Shpenzime të tjera nga puna	201,171	160,000	93,760	0.47	0.59	1.00
<b>Shpenzimet totale operative</b>	<b>4,438,899</b>	<b>5,189,150</b>	<b>4,570,316</b>	<b>1.03</b>	<b>0.88</b>	<b>48.66</b>
<b>Shpenzime të tjera</b>						
Interesi i kredive	283,220	270,000	272,146	0.96	1.01	2.90
Diferenca negative e kursit	2,823,013	1,650,000	4,549,078	1.61	2.76	48.44
<b>Totali i shpenzimeve të tjera</b>	<b>3,106,232</b>	<b>1,920,000</b>	<b>4,821,224</b>	<b>1.55</b>	<b>2.51</b>	<b>51.34</b>
<b>Shpenzimet totale</b>	<b>7,545,132</b>	<b>7,109,150</b>	<b>9,391,540</b>	<b>1.24</b>	<b>1.32</b>	<b>100.00</b>

Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore në vitin 2022 ka bërë shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 9.391.539.726 denarë. Rritja e shpenzimeve totale në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë vjen si pasojë e diferencave negative të kursit të këmbimit, të cilat vijnë nga lëvizja e kursit të këmbimit USD, valutë në të cilën NP për rrugët shtetërore ka huazuar në Eksim Bankën kineze, për projektet Milladinovci – Shtip dhe Kërçovë – Ohër.

Ilustrimi grafik nr.4: Shpenzimet e realizuara në raport me shpenzimet e planifikuara për vitin 2022



Ilustrimi grafik nr.5 Shpenzimet e realizuara për vitin 2022 krahasuar me të njëjtat shpenzime për vitin 2021




Shpenzimet operative për vitin 2022 arrijnë në 4.570.315.841 denarë. Shpenzimet operative në vitin paraprak arritën në 4.438.899.107 denarë dhe të njëjtat në vitin 2022 shënuan rritje prej 3%.

Sipas analizës strukturore dhe rritjes në përqindje, është vërejtur rritje e shpenzimeve të energjisë. Ato janë rezultat i ndriçimit dhe sinjalizimit në rrugë, nyjeve rrugore dhe objekte të ndërmarrjes. Sipas analizës strukturore dhe rritjes në përqindje, rritje më e madhe e shpenzimeve operative vihet re në shpenzimet e mirëmbajtjes së objekteve dhe rrugëve. Kjo është për shkak të rritjes së pagesave për mirëmbajtjen e rrugëve shtetërore drejt Ndërmarrjes Rrugët e Maqedonisë. Rritje krahasuar me një vit më parë vërehet edhe në zërin paga dhe shpenzime të tjera për të punësuarit. Kjo është për shkak të rritjes së angazhimit të të punësuarve (inkasuesve) në pikat e pagesës për shkak të frekuencës së shtuar të automjeteve në autostrada, gjë që shihet nga të ardhurat më të larta që krijohen nga taksa rrugore, pastaj për shkak të të punësuarve të rinj pas marrjes së pëlqimit nga institucionet kompetente për stacionet pagesore të reja në drejtimin rrugor Milladinovci – Shtip dhe për dallim nga vitet e kaluara kur

shpenzimet për të punësuar të përkohshëm janë evidentuar në zërin shërbime me natyrën e shpenzimeve materiale, nga ky vit janë evidentuar në zërin paga dhe shpenzime të tjera për të punësuarit.

Shpenzimet e tjera për vitin 2022 arrijnë në 4.821.223.885 denarë. Shpenzime të tjera përfshijnë diferencat negative të kursit të këmbimit dhe interesat e kredive. Në total, shpenzimet e tjera shënuan rritje krahasuar me një vit më parë si pasojë e diferencave më të vogla negative të kursit të këmbimit. Përkatësisht, Ndërmarrja mban evidencën kontabilistike dhe raportet në denarë. Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen me kursin e aplikueshëm të valutës së huaj në ditën e transaksionit. Të gjitha detyrimet në mjetet e huaja të pagesës janë llogaritur në ekuivalentin e tyre në denarë, sipas kursit mesatar të këmbimit të vlefshëm në ditën e bilancit. Diferencat pozitive dhe negative të kursit të këmbimit që janë shfaqur me detyrimet në mjetet e huaja të pagesave në vlerën e tyre ekuivalente në denarë janë shprehur në pasqyrën e të ardhurave si të hyra ose shpenzime nga financimi. Shumica e transaksioneve të Ndërmarrjes janë në EUR dhe USD. Kursi mesatar i euros më datë 31.12.2022 ishte 61,4932 MKD, ndërsa më datë 31.12.2021 ishte 61,6270 MKD, ndërsa kursi mesatar i dollarit shënoi rritje në krahasim me kursin e këmbimit në fund të vitit paraprak, përkatësisht 57,6535 MKD më datë 31.12.2022, ndërsa 54,37326 MKD më datë 31.12.2021.

Ilustrimi grafik nr.6 Pjesëmarrja e shpenzimeve individuale në totalin e shpenzimeve të realizuara për vitin 2022



## 5. SPECIFIKIMI I MJETEVE FIKSE DHE AMORTIZIMI

Në këtë pjesë të raportimit financiar paraqitet gjendja e aktiveve materiale dhe jomateriale individuale të ndërmarrjes, krahasimi i gjendjes së tyre me vitin paraprak, si dhe amortizimi i çdo aktivi individual me amortizimin e vitit paraprak.

Mjetet materiale	Objektet ndërtimore	Rrugët	Pajisjet	Paradhënie për furnizimin e mjeteve bazë	Investimet në vijim	Totali
Vlera e furnizimit						
Saldoja më 1 janar 2022	18,652,749	126,826,190,910	281,079,409	1,864,040,975	46,915,242,317	175,905,206,360
Rritja	17,010,767	1,944,455,859	16,497,495	176,825,567	8,349,488,336	10,504,278,024
Ulja	-		984,541	1,468,790,538	215,893,055	1,685,668,134
Saldoja më 31 dhjetor 2022	35,663,516	128,770,646,769	296,592,363	572,076,004	55,048,837,598	184,723,816,250
Korrigjimi i vlerës						
Saldo më 1 janar 2022	9,494,612	63,176,459,318	215,194,150	-	-	63,401,148,080
amortizimi	1,233,918	1,961,421,054	23,007,174			1,985,662,146
Ulja			984,541			984,541
Saldoja më 31 dhjetor 2022	10,728,530	65,137,880,372	237,216,783		-	65,385,825,685
Neto vlera kontabilistike më 31 dhjetor 2022	24,934,986	63,632,766,397	59,375,580	572,076,004	55,048,837,598	119,337,990,565
Neto vlera kontabilistike më 1 janar 2020 vitin aktual	9,158,137	63,649,731,592	65,885,259	1,864,040,975	46,915,242,317	112,504,058,280
Vlera e furnizimit						

Saldoja e datës 1 janar 2021	18,652,749	124,662,026,511	261,552,240	2,140,876,942	40,869,148,199	167,952,256,641
Rritja	-	2,164,368,372	28,638,677	653,382,553	6,068,256,346	8,914,645,948
Ulja	-	203,973	9,111,508	930,218,520	22,162,228	961,696,229
Saldoja më 31 dhjetor 21	18,652,749	126,826,190,910	281,079,409	1,864,040,975	46,915,242,317	175,905,206,360
Korrigjimi i vlerës						
Saldoja e 1 janar 2021	9,309,560	61,239,438,010	212,494,442		-	61,461,242,012
amortizimi	185,052	1,937,225,281	11,502,878		-	1,948,913,211
Ulja	-	203,973	8,803,170		-	9,007,143
Saldoja më 31 dhjetor 2021	9,494,612	63,176,459,318	215,194,150		-	63,401,148,080
Neto vlera kontabilistike më 31 dhjetor viti paraprak	9,158,137	63,649,731,592	65,885,259	1,864,040,975	46,915,242,317	112,504,058,280
Neto vlera kontabilistike më 1 janar 2021	9,343,189	63,422,588,501	49,057,798	2,140,876,942	40,869,148,199	106,491,014,629

Mjete jomateriale	Patentat dhe licencat	Gudvil	Soufter	Mjete tjera	Mjete në përgatitje	Totali
Vlera e furnizimit						
Saldoja më 1 janar 2022	1,633,918		43,522,088	916,158	-	46,072,164



Rritja			8,431,058	-		8,431,058
Ulja						-
Saldoja më 31 dhjetor 2022	1,633,918		51,953,146	916,158		54,503,222
Korrigjimi i vlerës						
Saldo më 1 janar 2022	1,633,918		42,363,344	916,162		44,913,424
amortizimi			2,213,470	-		2,213,470
Ulja						
Saldoja më 31 dhjetor 2022	1,633,918	-	44,576,814	916,162	-	47,126,894
Neto vlera kontabilistike më 31 dhjetor 2022	-	-	7,376,332	- 4	-	7,376,328
Neto vlera kontabilistike më 1 janar 2020 vitin aktual	-	-	1,158,744	- 4	-	1,158,740
Vlera e furnizimit						
Saldoja e datës 1 janar 2021	1,633,918		42,918,845	916,158		45,468,921
Rritja			603,243			603,243
Ulja						
Saldoja më 31 dhjetor 21	1,633,918	-	43,522,088	916,158	-	46,072,164
Korrigjimi i vlerës						
Saldoja e 1 janar 2021	1,633,918		34,439,403	632,674.00		36,705,995

amortizimi			7,923,941	283,488		8,207,429
Ulja						-
Saldoja më 31 dhjetor 2021	1,633,918	-	42,363,344	916,162	-	44,913,424
Neto vlera kontabilistike më 31 dhjetor viti paraprak	-	-	1,158,744	- 4	-	1,158,740
Neto vlera kontabilistike më 1 janar 2021	-	-	8,479,442	283,484	-	8,762,926

## 6. RISHIKIMI I KREDIVE

Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur kreditë afatgjata të ndërmarrjes publike, shuma e bazës së çdo kredie, norma e interesit, kohëzgjatja e kredisë, shuma totale e paguar dhe shuma që mbetet për t'u paguar.

	6. Rishikimi i kredisë	Shuma bazë	Norma e interesit	Shuma e anuitet 6-mujor	Totali i paguar deri më 31.12.2022	Borxhi i mbetur	Kohëzgjatja (nga - deri gjith. vitet)
	<b>Kredi afatgjate</b>						
1	Rrugët II EIB-Luksemburg	€ 60,000,000	3.62	1,752,266	54,743,203	5,256,797	15.11.2006-15.05.2024
2	TTFSEP-Banka Botërore	€ 14,670,375	Libor	610,240	12,839,653	1,830,722	15.12.2012-15.06.2024

3	Rugët lokale rajonale Banka Botërore	€ 69,124,920	Libor	2,390,417	42,761,759	26,363,161	15.09.2013-15.03.2028
4	* Projekti për rehabilitim in e rrugëve magjistrale Banka Botërore	€ 50,437,699	Libor	1,482,868	7,414,341	43,023,358	15.10.2020-15.04.2037
5	* projekti për përmirësim dhe zhvillim të rrugëve - Banka Botërore	€ 73,000,000	Libor	1,008,277	0	40,331,087	15.11.2023-15.05.2043
6	Rrugët rajonale dhe lokale BERZH	€ 50,000,000	Libor +1	2,419,225	47,580,775	2,419,225	15.12.2012-15.06.2023
7	Korridor X - Pikat pagesore BERZH	€ 15,880,000	Libor +1	996,000	8,907,997	6,972,003	20.10.2015-20.04.2026
8	* Programi për rrugë kombëtare të BERZH-it	€ 181,000,000	Libor +1	6,143,959	24,683,965	92,159,385	20.02.2018-20.02.2030
9	Segmenti rrugor Shtip - Radovish BERZH	€ 64,000,000	Libor +1	3,007,709	12,868,948	51,131,052	15.03.2020-15.09.2030
10	* Segmenti rrugor Kr. Pallankë-	€ 10,000,000	Libor +1	282,065	494,565	6,205,435	15.04.2022-15.10.2033

	Deve Bair BERZH						3
11	Korridori VIII - Pikat pagesore BERZH	€ 13,000,000	Libor +1	388,750	0	9,330,000	10.06.202 3- 10.12.203 4
	<b>Totali i kredive afatgjata euro</b>	€ 601,112,994		€20,481,17 6	€212,295,20 6	€ 285,022,225	
12	* Kërçovë- Ohër	\$505,044,96 7	2	\$16,082,24 0	\$77,651,317	\$353,809,277	21.07.201 9- 21.01.203 4
13	Milladinovc i- Shtip	\$213,699,63 2	2	\$7,123,321	\$49,863,247	\$163,836,385	21.07.201 9- 21.01.203 4
	<b>Totali i kredive afatgjata USD</b>	\$718,744,59 9		\$23,205,56 1	\$127,514,56 4	\$517,645,662	0

Vërejtje - Kreditë e shënuara me (\*) janë në fazën e zbatimit dhe janë ende në fazën e tërheqjes së mjeteve dhe për disa prej tyre ka filluar shlyerja e pjesës së tërhequr të kredive.

## 7. RAPORT MBI NDRYSHIMET NË KAPITAL

Ndryshimet në kapital më 31 dhjetor 2012 përbëhen nga rezervat e rivlerësimit që janë llogaritur për patundshmërinë, objektet dhe pajisjet më 31 dhjetor 2012 dhe fitimin e realizuar. Më 01.01.2013, me transformimin e "Agjencisë" në "Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore", është korigjuar kapitali, gjegjësisht kapitali bazë me 31.12.2020 është 5.000.000 denarë dhe përbëhet nga një depozitë në para. Mjetet merren nga gjendja e llogarisë së Agjencisë së Rrugëve Shtetërore në llogarinë e thesarit dhe janë pjesë e gjendjes në ditën e hapjes së llogarisë së NP për Rrugë Shtetërore. Ky kapital është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

në mijë denarë

7. Raport për ndryshime në kapitalin	Kapitali shtetëror	Rezervat e rizhvlerësuar	Fitimi i riinvestuar	Fitimi i grumbulluar (humbja)	Fitimi i vitit aktual	Totali i kapitalit
Gjendja më datë 1 janari 2021	5,000	9,796,453	2,885,001	42,627,572	4,595,660	59,909,686
Fitimi/Humbja për vitin aktual					1,473,676	1,473,676
Rezervat (fitimi i riinvestuar)			4,595,660	2,885,001	(4,595,660)	2,885,001
Kthimi i riinvestimit dhe akumulimi			(2,885,001)	-		(2,885,001)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	5,000	9,796,453	4,595,660	45,512,573	1,473,676	61,383,362
Gjendja më 01 janar 2022	5,000	9,796,453	4,595,660	45,512,573	1,473,676	61,383,362
Fitimi/Humbja për vitin aktual				-	3,448,047	3,448,047
Rezervat (fitimi i riinvestuar)			1,473,676	4,595,660	(1,473,676)	4,595,660
Kthimi i riinvestimit dhe akumulimi			(4,595,660)			(4,595,660)

			)			
Korrigjimet						-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	5,000	9,796,453	1,473,676	50,108,233	3,448,047	64,831,409

Nga tabela e dhënë shihet se kapitali i përgjithshëm në vitin 2022 është 64.831.409.287 denarë, dhe është rritur për 3.448.047.142 denarë në krahasim me vitin paraprak, përkatësisht është rritur për shumën e fitimit për vitin aktual.

## 8. RAPORTI I RRJEDHJES SË PARAVE

Raporti i rrjedhës së parasë na jep një pasqyrë të plotë të flukseve monetare të parave të gatshme në ndërmarrje, përkatësisht na tregon në një vend mbi çfarë baze ndërmarrja ka realizuar flukse monetare gjatë vitit 2021, dhe mbi çfarë baze janë bërë flukse monetare në të njëjtin vit.

Raporti i rrjedhës së parasë përgatitet bazuar në metodën direkte për llogaritjen e rritjes/uljes neto të mjeteve monetare.

*në mijë denarë*

8. RAPORTI I RRJEDHJES SË PARAVE	2021	2022	ndryshimi 2022/2021
Pranimi i parave nga kompensimet	8,120,849	9,726,485	1.20
Pranimet në para nga aktivitetet e tjera operative	26,785	135,432	5.06
Pagesat ndaj furnitorëve për shpenzimet bazë të veprimtarisë	-1,423,077	-1,144,639	0.80
Pagesat për pagat dhe kompensimet e pagës	-273,705	-390,347	1.43

Pagesat për shpenzime të tjera operative	-760,845	-997,622	1.31
Tatimi i paguar i fitimit	-40,498	-51,129	1.26
Interesi i pranuar	4,511	25,026	5.55
<b>Mjetet në para nga aktivitetet operative</b>	<b>5,654,019</b>	<b>7,303,206</b>	<b>1.29</b>
Huatë e dhëna/paguara për të tjerët	14,045	14,022	1.00
Furnizimi i mjeteve jomateriale	-603	-8,431	13.98
Blerjet e pasurive të patundshme, impianteve dhe pajisjeve	-11,848,974	-11,875,840	1.00
Paradhëniet e aktiveve fikse të dhëna/justifikuara, neto	276,836	1,291,965	4.67
<b>Mjetet në para nga investimet</b>	<b>-11,558,697</b>	<b>-10,578,284</b>	<b>0.92</b>
Interesi i paguar për kreditë	-283,220	-272,146	0.96
Kredi të marra (të shlyera) afatgjata, neto	10,817,075	8,283,837	0.77
Kreditë e shlyera	-3,626,814	-4,891,386	1.35
<b>Mjetet në para nga aktivitetet financiare</b>	<b>6,907,041</b>	<b>3,120,305</b>	<b>2.21</b>
<b>Rritja/ulja neto e flukseve monetare</b>	<b>1,002,364</b>	<b>-154,773</b>	<b>(6.48)</b>
<b>Mjetet në para në fillim të periudhës</b>	<b>1,191,199</b>	<b>2,193,563</b>	<b>0.54</b>
<b>Mjetet në para në fund të periudhës</b>	<b>2,193,563</b>	<b>2,038,790</b>	<b>1.08</b>

Në vitin 2022 nga rrjedha e parasë vërehet se ndërmarrja ka rënie të rrjedhës së parasë në vlerë prej 154.772.718 denarë. Ndërmarrja tregon flukse monetare hyrëse nga aktivitetet operative dhe shuma e tyre është 7.303.206.014 denarë, dhe të njëjtat janë janë më të larta se në vitin paraprak. Ndërsa dalje të parave të gatshme ndërmarrja shfaqë në aktivitetet investive. Mjetet monetare të ndërmarrjesë në fund të vitit arrijnë në vlerë 2.038.789.877 denarë.

## 9. PASQYRË E TË DHËNAVE VJETORE

Në këtë pjesë të raportit, do të paraqiten në tabelë zërat nga bilancet dhe raportet për vitin 2022 që janë të rëndësishëm për ndërmarrjen dhe krahasimi i tyre në raport të rënies/rritjes me vitin paraprak.

në mijëra denarë

9. PASQYRË E TË DHËNAVE VJETORE	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Ndryshimi 2022/2021
Aktiva aktuale	2,468,251	2,177,140	0.88
Detyrimet aktuale	9,429,030	9,924,903	1.05
Të hyrat totale nga veprimtaria	8,326,816	10,064,448	1.21
Të hyrat totale	9,026,166	13,065,011	1.45
Shpenzimet totale nga veprimtaria	4,438,899	4,570,316	1.03
Shpenzimet totale	7,545,132	9,391,540	1.24
Shpenzimet e pagave	273,890	390,736	1.43
Shpenzimet totale të kredive	283,220	272,146	0.96
Rezervat	14,392,113	11,270,129	0.78
Kapitali (investimi, përlllogaritja e fitimit)	45,517,573	50,108,233	1.10
Fitimi/Humbja	1,473,676	3,448,047	2.34
Totali i mjeteve materiale	112,504,058	119,337,991	1.06
Totali i mjeteve jomateriale	1,159	7,376	6.36
Burimet financiare afatgjata	21,010	6,988	0.33
Mjetet e përgjithshme	114,994,478	121,529,495	1.06

Gjatë vitit 2022, vëllimi i regjistrimit kontabël të të gjitha dokumenteve financiare është si më poshtë:

1. Dokumentet dalëse – 12 552 (fatura).
2. Dokumentet hyrëse – 6,196 (fatura, situata dhe urdhërpagesa).
3. Pasqyra bankare - 25,273 (ndryshime kanë ndodhur në të gjitha llogaritë e NPRRSH me një total prej rreth 144,000 zëra.
4. Janë pranuar dhe shqyrtuar 846 kërkesa në vlerë prej rreth 130 milionë denarë për kthimin e mjeteve për vetura me vendbanim jashtë vendit.



## VI. INVESTIME

Investimet janë një kalim drejt kursimeve në fondet kapitale. Në thelb, investimet janë diferenca midis të ardhurave totale dhe konsumit gjatë një periudhe kohore, të cilat shëndërrohen në mallra kapitale fikse dhe korrente. Investimet llogariten ndër faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Investimet a.q. kapitali krijohet nga kursimet e brendshme (akumulimi) dhe kapitali i marrë hua nga jashtë, në formën e kredive dhe investimeve të huaja direkte. NPRRSH siguron mjete kapitale nga kursimet e brendshme dhe huatë e huaja.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur investimet nga mjetet vetanake dhe investimet me kredi të huaja të realizuara në vitin 2022 dhe krahasimi i tyre me vitin paraprak.

Programi Vjetor	Realizimi 2021	Programi 2022	Realizimi 2022	2022/2021	Realizimi i planifikuar 2022	Analizë strukturore të realizimit 2022
INVESTIME	7,482,513,916	22,111,474,000	8,598,648,407	1.15	0.39	1.00
Investime nga mjetet vetanake	2,770,444,779	2,855,600,000	2,600,138,169	0.94	0.91	0.30
Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve shtetërore	985,845,059	896,600,000	824,675,862	0.84	0.92	0.10

Rrëshqitjet e dheut dhe rehabilitimi i urave dhe tuneleve	284,280,877	256,200,000	266,551,241	0.94	1.04	0.03
Ndriçimi dhe sinjalizimi dhe pajisjet rrugore	18,035,152	15,000,000	4,239,457	0.24	0.28	0.00
Pjesëmarrja vetanake në investime nga huatë e huaja	186,297,372	342,000,000	327,034,710	1.76	0.96	0.04
Mirëmbajtja e investimeve	517,348,718	714,000,000	588,077,968	1.14	0.82	0.07
Shpronësimi	209,679,036	200,000,000	176,046,115	0.84	0.88	0.02
Projektimi	78,054,947	110,580,000	45,351,530	0.58	0.41	0.01
Mbikëqyrja e punëve ndërtimroe	303,606,456	263,520,000	362,098,283	1.19	1.37	0.04
Pajisjet dhe Softueri	7,297,162	57,700,000	6,063,003	0.83	0.11	0.00
Investime nga kredit e huaja	<b>4,712,069,137</b>	<b>13,317,000,000</b>	<b>5,998,510,238</b>	<b>1.27</b>	<b>0.45</b>	<b>0.70</b>
Investime me kredi nga Banka Botërore	418,414,665	2,757,000,000	653,051,678	1.56	0.24	0.08
Përmirësimi dhe zhvillimi i rrugëve	418,414,665	2,757,000,000	653,051,678	1.56	0.24	0.08
Investime me kredi nga BERZH	3,209,833,607	5,560,000,000	2,440,319,849	0.76	0.44	0.28
Projekti për sistemin elektronik për pagesë të taksës rrugore	60,535,135	13,000,000	4,025,127	0.07	0.31	0.00

Projekti për ndërtimin e rrugëve kombëtare	1,380,164,12 2	4,383,000,000	1,697,240,036	1.23	0.39	0.20
Shtip - Radovish, ndërtimi i rrugës së shpejtë	1,538,721,20 3	293,000,000	293,014,061	0.19	1.00	0.03
Kriva Pallankë - Deve Bair	93,715,391	300,000,000	160,995,457	1.72	0.54	0.02
Projekt për pikat pagesore në Korridorin 8	136,697,756	165,000,000	285,045,168	/	1.73	0.03
Bujokçani-Kërçovë	0	306,000,000	0	/	0.00	0.00
Shkup - Bllacë	0	100,000,000	0	/	0.00	0.00
Investime me kredi nga Eksim Bank	1,083,820,86 5	5,000,000,000	2,905,138,711	2.68	0.58	0.34
Kërçovë - Ohër, ndërtimi i autostradës	1,083,820,86 5	5,000,000,000	2,905,138,711	2.68	0.58	0.34
Investimet në infrastrukturën rrugore nga mjetet buxhetore	0	5,938,874,000	0	/	0.00	0.00

## 1. INVESTIME ME MJETE VETANAKE

### 1.1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrugëve shtetërore, rrëshqitjet e dheut, urave dhe tuneleve, ndriçimi dhe sinjalizimi i rrugëve

- Qytet i Diellit, në gjatësi prej 4.4 km Punët ndërtimore kanë përfunduar plotësisht. NP për rrugët shtetërore ka aplikuar në Ministrinë e Transportit dhe

Lidhjeve për ndryshimin dhe plotësimin e projektit infrastrukturor dhe bazë. Pas miratimit të dokumentacionit të nevojshëm nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, NP për Rrugë Shtetërore do të aplikojë për kryerjen e kontrollit teknik dhe vënien në përdorim të rrugës.

- Rindërtim të rrugës regjionale krahu 1 i R-418 (faza 2), në shtrirjen Fabrika “Vevçanka – Shtëpia e Shëndetit Vevçani, Komuna e Vevçanit në gjatësi prej 1 km. Rruga ka përfunduar në dhjetor 2020. Janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejes për përdorim.
- Ndërtimi i rrugës rajonale Konjarevë e Vjetër - Konjarevë e Re (komuna Novo Sellë - Strumic), në gjatësi prej 3.4 km. Rruga ka përfunduar në qershor 2020. Janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejes për përdorim
- Rikonstruim i rrugës shtetërore R2133, segmenti Mateç - Likovë, në gjatësi prej 3.3 km. Rruga ka përfunduar në prill 2021. Janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejes për përdorim.
- Rikonstruim i rrugës shtetërore R2133, segmenti Ropalcë- Mateç, në gjatësi prej 2.78 km. Punët ndërtimore kanë filluar në maj 2021, ndërsa kanë përfunduar në korrik 2022.
- Ndërtimi i autostradës A4, segmenti PK “Bllacë” – Shkup (nyja rrugore “Stenkovec”) Nësegmenti 1 – zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PK “Bllacë” deri në fshatin Bllaca deri në nivelin e autostradës dhe ndërtimi i një pjese të autostradës me një kryqëzim për t'u lidhur me një rrugë lokale për në fshatin “Bllacë” – Punët ndërtimore kanë filluar në vitin 2020 dhe pritet të përfundojnë në fund të vitin 2023.
- Ndërtimi i urës në rrugën shtetërore R2136 në lumin Pçinja në Konjare. Ura ka përfunduar në tetor 2020 . Janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejes për përdorim.

- Ndërtimi i rrugës rajonale segmenti R2246, Izvor (lidhje me A2) – Ura e Garskit në gjatësi prej 19.00 km. Punët ndërtimore kanë filluar në vitin 2021 dhe pritet të përfundojnë në vitin 2023
- Rehabilitimit dhe riparim i rrugës shtetërore R1203, segmenti Tetovë-Xhepçishte në gjatësi prej 4 km. Punët ndërtimore kanë filluar në vitin 2021 dhe pritet të përfundojnë në maj 2022.
- Rikonstruim i rrugës shtetërore R1109, segmenti: Qarkorja e Bogdancit, seksioni 1, km 0+0,000 – km 2+675. Punët ndërtimore kanë filluar në tetor 2022 dhe pritet të përfundojnë në maj 2023.
- Realizimi i kontratave për Mirëmbajtjen e pajisjeve EE, ndriçimin, sinjalizimin dhe sistemin e ndriçimit, Mirëmbajtjen e pajisjeve për furnizim të pandërprerë dhe rezervë me energji elektrike, mirëmbajtjen, përmirësimin dhe numërimin e trafikut për një kohëzgjatje prej dy vitesh, mirëmbajtjen e pajisjeve GPS për sportelet e automjeteve, në kohëzgjatje prej dy vitesh, mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit ekzistues elektronik për mbledhjen e taksës rrugore dhe analizën dhe mendimin e ekspertëve konsultativ, mirëmbajtjen e ashensorëve për një kohëzgjatje prej dy vitesh, mirëmbajtjen e pajisjeve KZ dhe ekzaminimin e instalimit të mbrojtjes nga rrufetë dhe tokëzimi mbrojtës, mirëmbajtja e sistemit për mbrojtje KZ dhe njoftimi i sistemit të zjarrit dhe alarmit, mirëmbajtja e kondicionerëve dhe sistemeve të kondicionimit, mirëmbajtja e pajisjeve të vëzhgimit me video, mirëmbajtja e rampave automatike të ndalimit, mirëmbajtja e kabllit optik në autostradën A4, Shtip - Milladinovci, dhënia me qira e mekanizimit për nevojat e qendrës së kontrollit të Negotinës për një periudhë tre vjeçare, mirëmbajtja e pajisjeve për sistemin elektronik të mbledhjes së taksës rrugore në korridorin 10, mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e sistemit RAMS për një periudhë dy vjeçare, mirëmbajtja e sistemit dhe pajisjet e tunelit, mirëmbajtja e ndërtesave dhe objekteve. Janë nënshkruar kontrata me Realizuesit.

- Punë riparuese ndërtimore të urës nr. 1 në R1103, Lakavicë, punët ndërtimore kanë përfunduar në tërësi.
- Punë riparuese ndërtimore të urës nr. 3 në R1103, Lakavicë, punët ndërtimore kanë përfunduar në tërësi.
- Riparimi i urës të Lumit Pçinja (Dobroshane), punët ndërtimore kanë përfunduar në tërësi.
- Punë riparuese ndërtimore të urës nr. 4 në R1103, Lakavicë, punët ndërtimore kanë përfunduar në tërësi.
- Riparimi i urës të Lumit Kumanovë në rrugën shtetërore R1204, punët ndërtimore kanë përfunduar në tërësi.

## 1.2. Mirëmbajtja investituese

Sipas Kontratës për mirëmbajtje të lidhur me NP Rrugët e Maqedonisë, në pozicioni 1.1. Përmirësimi dhe riparimi i rrugëve në vitin 2022 janë kryer punë në drejtimet rrugore të mëposhtme:

1. R2238 Mavrovë-Galiçnik
2. R2245 Kriva Pallankë-Ogut
3. R2242 Shemshovë - Zhelinë
4. R29275 Shipkovicë-Bozovcë
5. R1104 Kumanovë-Sopot
6. R1104 kryqëzimi me A2-Haraçinë
7. R2133 Likovë - Orizarë
8. R2239 Çuçer -Tanushë
9. R1206 Saraj -Karpallak
10. R2135 Preod - Gorubinci
11. R1304 Prevalec-Vinicë
12. R1204 Shtip – kryqëzimi me A4

13. R1403 Radovish-Voisllavci
14. R1402 Gabrovë-Koleshinë-Smolare
15. R2251 Probishtip-Lesново
16. R1404 kryqëzimi me A4 - Robovë - Murtino
17. R2336 Martolci-Petle
18. R1108 Gorniçet-Ujë me erë
19. R29171 qarkorja Demir Kapi
20. R1103 Negotinë-Glishiq
21. R2331 Manastir -Nizhe polë
22. R2332 kryqëzimi me 1307-Galiçicë- kryqëzimi me R1301
23. R29372 kryqëzimi me A3-Rotino
24. R2339 kryqëzimi me A3-Logaë e Re- Buçin
25. R1107 Vitolishte-f.Manastir
26. R1305 Zheleznec-Demir Hisar
27. R2335 Krivogashtan- Zhitoshë

### 1.3. Projektet infrastrukturore

Projektet e mëposhtme janë në fazën e zhvillimit:

- Përgatitja e Projektit Infrastruktural dhe Bazë për rrugën shtetërore A2, pjesa Bukojçan - Kërçovë
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për Strumicë - Valandovë - Kryqëzimi me A1;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrugëve shtetërore financuar nga BERZH (faza 2). Projektimi ka mbaruar në prill 2022.

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e segmenteve të autostradës: -Hipodrom-Milladinovci, Milladinovci-Petrovec dhe Petrovec-Hipodrom. Projektimi ka mbaruar në prill 2022.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për segmentin e autostradës Manastir - Mexhitli, me qarkoren e Manastirit;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën shtetërore A3, Qarkorja e Resnjës;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rikonstruim dhe zgjerimin e rrugës rajonale R1109 segmenti Ura e Ponovit - hyrja në Bogdanci. Dokumentacioni projektues ka përfunduar në vitin 2022
- Kompletimi i dokumentacionit ekzistues të projektit dhe përgatitja e projektit të infrastrukturës për rikonstruim me zgjerimin e rrugës rajonale R2236, segmenti Sveti Nikollë - Neokazi.
- Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacionit të projektit për kyçjen e autostradës së ardhshme A4, segmenti Milladinovci - Sveti Nikollë - Shtip (kryqëzimi i Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për vendosjen e sinjalizimeve dhe pajisjeve të komunikacionit në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër.
- Ndryshimi dhe plotësimi i infrastrukturës për ndërtimin e rrugës rajonale R2138, lidhje me rrugën rajonale R2134, me vendbanimin Qyteti i Diellit. Kontrata u nënshkrua në korrik 2020.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtim të Qarkores Tetovë përmes unazë Trebosh deri në Neproshtenë. Kontrata e lidhur më korrik 2021
- Kompletimi i dokumentacionit projektues për zgjerimin dhe përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës shtetërore në rrugën rajonale R2235 segmenti Nikikorovë-leonovë- Bunec. Kontrata e lidhur më tetor 2022.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrugës shtetërore A2 Qarkorja e Kriva Pallankës. Kontrata e lidhur më tetor 2022.



#### 1.4. Shpronësimi

Në vitin 2022, pagesat janë bërë në bazë të marrëveshjeve për shpronësim, marrëveshjeve gjyqësore, vendimeve gjyqësore dhe vendimeve për përfaqësuesit e përkohshëm në procedurat e shpronësimit për projektet e mëposhtme:

- Ndërtimi i autostradës A2 Kërçovë - Ohër në gjatësi prej 56.7 km; Autostrada A2, segmenti Kërçovë-Ohër, është e ndarë në 5 nënsegmente. Procedura për shpronësimin e tokës për trasën kryesore për gjithsej 17-shtatëmbëdhjetë deponive dhe 5-pesë kryqëzimeve, Kryqëzimi rrugor i paniveluar Trebenishte, Kryqëzimi rrugor Podmolje, Kryqëzimi rrugor Aeroporti Shën Apostol Pavle, dhe për 13-trembëdhjetë shpate është zbatuar. Për shkak të problemeve me pjerrësitë e këtij segmentit të autostradës, u lind nevoja për plotësimin e dokumentacionit teknik për shpatet dhe shpronësime shtesë. Janë projektuar gjithsej 67 rampa të reja përgjatë gjithë segmentit të autostradës dhe që nga viti 2022, të 67 projektet e infrastrukturës së rampave janë miratuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjes. Nga gjithsej 67 projekte, deri në fund të vitit 2022 ka përfunduar procedura e shpronësimit për 58 pjerrësi. Përveç projekteve të infrastrukturës për pjerrësi, janë projektuar edhe 8 (tetë) projekte për devijime në rrugët lokale, nga të cilat për 4 devijime kanë filluar procedurat e shpronësimit gjatë vitit 2022, nga të cilat procedura e shpronësimit ka përfunduar plotësisht. Është miratuar edhe Projekti Infrastrukturor për ndërtimin e Landfillit, për të cilin ka përfunduar plotësisht edhe procedura e shpronësimit. Paralelisht me procedurën e shpronësimit, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave kanë filluar procedurat për shndërrimin e përhershëm të pyjeve dhe tokës pyjore në tokë ndërtimore dhe procedurat për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Në Gjykatën Themelore të Kërçovës dhe Ohrit dhe në Gjykatën e Apelit Gostivar dhe Manastir janë duke vazhduar

procedurat jashtëkontestimore për përcaktimin e kompensimit për pronën e shpronësuar.

- Ndërtimi i autostradës Milladinovci-Sveti Nikollë-Shtip në gjatësi prej 47 km. Nga viti 2022 ka përfunduar procedura e shpronësimit për zgjerimin e shpateve të ndërtuara dhe procedurat për kthimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe janë miratuar Vendimet e Qeverisë së RMV për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Procedura për marrjen e lejes së përdorimit para MTL është në proces. Nga viti 2022 ka filluar procedura e shpronësimit për ndërtimin e autostradës A4, segmenti Milladinovci-Sveti Nikollë-Shtip për rrugë dalëse dhe hyrëse (nga km.26+396.47 deri në km.41+625.00), segmenti Sveti Nikollë-Shtip në KK Preot, KK Sveti Nikollë qytet dhe KK Sveti Nikollë jashtë qytetit dhe KL Sopot është në fund. Pjesa tjetër nuk është e shpronësuar, edhe një parcelë kadastrale në Komunën e Preodit për të cilën nuk ka akt dhe menaxhohet në DÇPJ Sveti Nikollë.
- Projekti i ndërtimit të A1 Prilep-Gradsko, segmenti nga ura në lumin Raec përmes DPJ Drenovë deri në DPJ Gradsko (kryqëzimi me A1) nga km. 10+216 deri në km.25+477.60 në Komunën Rosoman dhe Komunën Gradsko. Në fund të vitit 2022 është miratuar projekti i infrastrukturës për ndryshimin dhe plotësimin e Projektit të Infrastrukturës për drejtimin rrugor të lartpërmendur, me të cilin pritet të nisë procedura e shpronësimit.
